

ANULLIM I PROCEDURËS SË TENDERIT

Data: 10 Nëntor 2023

II.1.1) Titulli i Njoftimit për Kontratë: Thirrje për Propozim: Toka Jone – Përdorimi i pasurisë së konfiskuar për bujqësi sociale, Fondi për Zhvillimin e Bujqësisë Sociale (SADF)

II.1.2) Numri i Referencës: EuropeAid/171607/DD/ACT/AL

IV.2) Informacion administrativ

IV.2.1) Njoftimi i mëparshëm në lidhje me këtë procedurë

Thirrja për propozime nën Fondin për Zhvillimin e Bujqësisë Sociale u lançua më 13 shkurt 2023 dhe afati për dorëzimin e aplikimeve u vendos më 27 mars 2023. Informacioni relevant dhe udhëzimet e plota për aplikuesit ishin të disponueshme për konsultim në linkun

<https://www.cosv.org/news-press> dhe në faqen në internet:

<https://webgate.ec.europa.eu/europeaid/online-services/index.cfm?do=publi.welcome>.

Seksioni V: Dhënia e kontratës

Asnjë kontratë nuk është dhënë nën këtë thirrje.

V.1) Informacion mbi mosdhënien e kontratës

Skema e nën-grantimit Toka Jonë– Përdorimi i pasurisë konfiskuar për bujqësi sociale (SADF) është anuluar për shkak të rishikimit dhe përditësimit të procedurave të vlerësimit. Thirrja për Propozime (CfP) është fokusuar te iniciativat bujqësore sociale, për të cilën ka nevojë për një nivel specifik ekspertize, ekspertize kjo që do të ofrohet nga ekspertë të jashtëm. Vendimi për ri-hapjen e skemës së nën-grantimit është bërë duke marrë parasysh këto aspekte teknike, duke njohur nevojën për ekspertë me përvojë të provuar në fushën e menaxhimit të projekteve në lidhje me Iniciativat Bujqësore-Sociale dhe zhvillimet socio-ekonomike, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i sukseshëm i projektit dhe në përputhje të plotë me qëllimet e tij.

V.2) Informacion shtesë:

Një procedurë e re tenderuese / thirrja për propozime (CfP) do të ri-hapet më 15 nëntor 2023 dhe të gjitha informacionet relevante dhe udhëzimet e plota për aplikuesit do të jenë të disponueshme për konsultim në linkun: <https://www.cosv.org/news-press>.